



VENDIM

Nr. 3 Datë 11.12.2010

PËR

**MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË TRANSMETIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE MIDIS OST SH.A DHE CEZ SHPËRNDARJA SH.A**

Në mbështetje të nenit 9 të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, pikës “V” të Rregullave të Tregut Shqiptar të Energjisë, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 68, datë 23.06.2008, pikës 4.13 gërma “a” pika 3, pikës 7 gërma “g”, të Modelit të Tregut të Energjisë Elektrike miratuar me VKM nr. 338, date 19.03.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 11.12.2010, pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoritë Teknike të ERE-s dhe marrëveshjen e transmetimit të energjisë elektrike midis OST sh.a dhe Cez Shpërndarja sh.a,

Konstatoi se:

- Palët e kësaj kontrate janë subjekte të legjitimuara për nënshkrimin e një marrëveshje për shërbimin e transmetit të energjisë elektrike duke ditur që OST sh.a është licensuar për aktivitetin e Transmetimit të Energjisë Elektrike me Vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s, nr. 24, datë 26.03.2009, Cez Shpërndarja sh.a është licençuar për aktivitetin e shpërndarjes së energjisë elektrike me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s, Nr.58 datë 03.06.2008.
- Dispozitat e kësaj kontrate janë në harmoni me Modelin e Tregut të Energjisë miratuar me VKM nr.338 datë 19.03.2008, Rregullat e Tregut të miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.68, datë 23.06.2008, të ndryshuar.
- Modeli i Tregut vendos ERE-n në cilësinë e autoritetit që ka të drejtën për të miratuar këtë kategori kontratë.

Per gjithë sa me sipër Bordi i Komisionereve,

Vendosi :

1. Të miratojë marrëveshjen e Shërbimit të Transmetimit të Energjisë Elektrike midis OST sh.a dhe Cez Shpërndarje sh.a, dërguar në ERE me shkresën nr. 6755/2 Prot dhe nr. 2538/2 Prot datë 02.11.2010.
2. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit për njoftimin e palëve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.